



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.08.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 18.06.2020; 23.06.2020; 02.07.2020; 07.07.2020; 09.07.2020 dhe 16.07.2020.

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023 të sistemit gjyqësor (faza e dytë)”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 16:00 dhe mbaroi në orën 17:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Ilir Toska | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 8. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Dritan Hallunaj*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Medi Bici*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
5. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 18.06.2020; 23.06.2020; 02.07.2020; 07.07.2020; 09.07.2020 dhe 16.07.2020.

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023 të sistemit gjyqësor (faza e dytë)”.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Atëherë, siç jeni vënë në dijeni, prezent janë të gjithë anëtarët e Këshillit. Po fillojmë mbledhjen e datës 7 gusht. Prezent janë të gjithë anëtarët e Këshillit, përveç zotit Hallunaj, që ka njoftuar për pamundësinë e tij për të qenë në këtë mbledhje edhe zoti Bici, i cili në fakt kishte njoftuar që do të ishte, por ndoshta për shkak të pamundësisë për

t'u lidhur me internetin, e bën të pamundur që të jetë prezent. Megjithatë ne mund ta vazhdojmë mbledhjen, pasi kemi kuorumin që parashikon ligji.

Siç jeni në dijeni, sot nga ana e Këshillit do merren në shqyrtim 4 çështje. E para bën fjalë për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat respektive 18.06.2020; 23.06.2020; 02.07.2020; 07.07.2020; 09.07.2020 dhe 16.07.2020. Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023 të sistemit gjyqësor (faza e dytë)”. Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, si dhe vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur të dy këto vendime nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Atëherë, jeni dakord me rendin e ditës?

Marçela Shehu: Kryetare, në fakt kisha unë diçka. Përshëndetje!

Naureda Llagami: Në fakt, sa do ta thosha Marçela.

Nga ana e zonjës Shehu është bërë një kërkesë me e-mail, në të cilën kërkohet që të hiqet nga rendi i ditës, pra të shtyhet, çështja 2, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023 të sistemit gjyqësor (faza e dytë)”.

Atëherë, thjesht për informacion, përpara se ta lë në vlerësimin tuaj, arsyeja pse ky projekt-akt u fut me urgjencë është se, së pari, kërkesa nga ana e Ministrisë së Financave ka ardhur në fund të korrikut, pra ka ardhur në ditët e fundit. Nga ana e stafit është punuar intensivisht që të përgatitej ky projekt-akt, por nga ana tjetër, kërkohet që projekt-akti duhet të miratohet sa më shpejt nga ana e KLGJ-së, për të vijuar më pas përcjelljen e tij pranë Ministrisë së Financave, dhe kjo është përpara fundit të gushtit. Ky

është një afat ligjor që parashikon ligji “Për menaxhimin e buxhetit”. Kjo ka qenë arsyeja pse e kemi vlerësuar si të ngutshme.

Nga ana tjetër, sjell në vëmendje që edhe nga ana e stafit që përpunon projektbuxhetin është parashikuar që të bëjnë lejen e zakonshme dhe për këtë arsye, duke qenë se pas miratimit nga ana jonë, në rast se ne vlerësojmë sot që ta përfshijmë në mbledhjen plenare, pra mos ta shtyjmë, duhet edhe një javë tjetër që të punohet me projekt-aktin, më zbardhjen e tij, për t’ia përcjellë Ministrisë së Financave. Kjo është arsyeja e urgjencës së projekt-aktit, të përfshirjes në mbledhjen plenare.

Marçela Shehu: Kryetare, të sqaroj diçka të lutem?

Naureda Llagami: Po, Marçela!

Marçela Shehu: Kur unë kërkova, jo që të hiqet nga rendi i ditës, por që të shtyhet shqyrtimi i kësaj pike për një datë tjetër, u nisa nga fakti që si planifikimi ashtu edhe administrimi i buxhetit janë një nga kompetencat kryesore që ka Këshilli. Kështu që një çështje kaq e rëndësishme nuk mund të kalojë pa u shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha ato tema që trajton relacioni. Duke qenë se relacioni na është vënë vetëm pardje në dispozicion dhe nuk është i shoqëruar me të gjitha ato akte bazuar në të cilat ky relacion është hartuar, unë për të qenë e bindur në atë që do të votoj, kam kërkuar që kjo çështje të shtyhet për shqyrtim, duke kërkuar njëkohësisht që kjo çështje të trajtohet në mbledhjen më të afërt të mundshme (pra nuk është se po kërkoj shumë kohë) dhe gjatë kësaj kohe të vihen në dispozicion edhe të gjitha materialet bazuar në të cilat është mbështetur si Komisioni ashtu edhe drejtoria përkatëse për të bërë ato parashikime që janë bërë. Gjithsesi, kjo mbetet në vlerësimin e Këshillit. Por unë nuk jam në kushtet për të dhënë mendimin tim lidhur me atë çka është propozuar. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Mundem?

Naureda Llagami: Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Atëherë, edhe unë jam në të njëjtën situatë me atë që sapo parashitroi Marçela, por mendoj që nuk duhet të jetë çështje votimi, se mjafton që njëri

nga anëtarët të mos jetë në gjendje që të vlerësojë dhe të votojë, mendoj që kjo duhet të shtyhet.

Në qoftë se ka këtë emergjencën, hajde ta zgjidhim pa prishur asnjë lloj pune, asnjë lloj situatë, të jetë në rregull me ligjin. Ta shtyjmë në një moment tjetër që edhe të na vihen në dispozicion të gjithë ato aktet që përmendi Marçela. Kështu që edhe unë jam me këtë qëndrim.

Naureda Llagami: Faleminderit, Bruna!

Ndonjë ide tjetër përpara se ta hedhim në votim.

Luljeta Laze: Më fal, mundem edhe unë Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Luli!

Luljeta Laze: Atëherë, u përmend fjala 'emergjencë', në fakt unë dua të shpjegoj procedurën normale ligjore që na detyrojnë aktet dhe atë çfarë neve konkretisht kemi zbatuar. Procesi i projektbuxhetit, sipas udhëzimit standard fillon që në muajin mars. Në fakt, në udhëzimin që na ka ardhur neve në muajin mars, kuptohet, ishte periudha e mbylljes dhe në udhëzimin e parë parashikohej që juve vetëm do bëni disa parashikime buxhetore referuar shpenzimeve historike që keni, pra përjashtohet mundësia që të bëhej një plan i detajuar me institucionet e varësisë. Gjithashtu, nuk na u dërguan tavanet, ato mbi të cilat janë elementë bazë që neve bëjmë krahasimin e kërkesave tona buxhetore me tavanët dhe mbi të cilat ndërtohen edhe argumentat pse kërkojmë më shumë apo më pak (çfarëdo që të jetë), në raport me këto tavane që na vijnë nga qeveria.

Megjithatë, neve gjithsesi e kemi filluar procesin në atë kohë, ia kemi kërkuar gjykatave dhe kemi marrë informacion të detajuar prej tyre, duke menduar që... Sepse referuar asaj periudhe që po përjetonim, thamë që neve le ta bëjmë këtë gjënë dhe të gjithë mendonim që mund të kishim disa buxhete shumë të vogla dhe thamë, të paktën, duke pasur të qartë çfarë kanë kërkuar gjykatat, ne do jemi në gjendje që të vendosim prioritetet. Kështu që neve, në një farë mënyre e realizuam procesin tonë me gjykatat.

Në fund të korrikut, 28 korrik na kanë ardhur në institucion tavanet, ato që normalisht nuk duhet të kishin ardhur që në muajin mars. Pra ne ishim të detyruar tashmë, patjetër që donim të verifikonim situatën tonë buxhetore, pra kërkesat që ishin hartuar mbi bazën e kërkesave të institucioneve të varësisë, me tavanet që na kanë ardhur.

Prandaj ishte kjo që brenda kësaj jave neve u detyruam që i ripunuam edhe një herë materialet, për t'i verifikuar me këto tavane dhe për të ndërtuar argumentat tona.

Tani, për çfarë bëhet fjalë për emergjencë?! Nuk është se ka ndonjë emergjencë, por edhe ka brenda saj, -për arsye se, ka një afat ligjor deri në 30 gusht, që projektbuxheti duhet dorëzuar në Ministrinë e Financave, për t'u lëvizur mbrapsht ashtu sikurse u tha edhe në fillim, ku ne na duhet minimalisht një javë kohë (10 ditë po themi me të shtunë, të diel brenda) sepse i gjithë ky projektbuxhet që ju miratoni, kthehet në disa formate tabelare, që kërkon Ministria e Financave, për çdo gjykatë, pra ka një punë që nuk është se do vëmendje të madhe por do punë fizike, pra do kohë që të përpunohet.

Pra, në qoftë se do ketë (kjo është vendimmarrja juaj e ju e dini se çdo bëhet) një mbledhje tjetër, domethënë i bie që të paktën deri në datën 20 kjo mbledhje duhet bërë, por do t'ju lutesha që të mendoni që edhe ne duam të shkojmë të bëjmë ndonjë ditë pushim. Pra javën e parë ndenjëm që ta ripunonim edhe një herë materialin. Të kishim pak pushim, -thamë, dhe të ktheheshim në datën 20 për t'i ripunuar edhe një herë këto. Megjithatë, vendimmarrja është e juaja.

Kisha edhe një paqartësi lidhur me kërkesën që u bë për aktet.

Në faqen 4 të materialit që kemi bërë, ne kemi parashtruar të gjitha aktet që ne kemi zbatuar për hartimin e këtyre kërkesave buxhetore. Nuk e di për çfarë aktesh të tjera bëhet fjalë, që kërkohen dhe s'i kemi vënë në dispozicion? Çfarë aktesh?

Marçela Shehu: Luli, përshëndetje!

Luljeta Laze: Përshëndetje!

Marçela Shehu: Atëherë, në planifikimin që është bërë për shembull për buxhetin e gjykatave, janë përmendur disa nevoja të gjykatave. E kemi komunikimin me gjykatën, për të parë si/çfarë është kërkuar?

Luljeta Laze: Atëherë, unë dua t'ju shpjegoj diçka, sepse meqenëse kjo është puna jonë (të më falni për këtë). Materiali që është përgatitur për Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, sikurse ju e shikoni, është më i detajuar sesa ai relacioni. Menduam (të dy bashkë me Xhodën) që të dërgonim një relacion që të ishte më sintetik për ju (për Këshillin), në mënyrë që, aty janë të vendosur piketat e kërkesave buxhetore dhe kemi vënë në dispozicion edhe të gjithë materialin që është për Ministrinë e Financave dhe të

Ekonomisë, ku është çdo gjë më e detajuar. Përveç këtyre, pra është më i detajuar sesa relacioni që kemi përgatitur për ju. Përveç kësaj, ka akoma material tjetër akoma më të detajuar nga çdo gjykatë. Tani, në qoftë se mendoni për këtë, dakord. Por çfarë pune bëjmë ne pastaj, që i mbledhim këto, i sintetizojmë, i nxjerrim në konkluzione. Megjithatë, në qoftë se mendoni për këtë, është një tjetër gjë pastaj.

Xhevdet Haxhiu: A të shtoj diçka të lutem?

Naureda Llagami: Po Xhoda, se në fakt duhej sqarim vetëm për çështjet që mund të kishte paqartësi Marçela dhe pastaj Këshilli do vlerësojë nëse do ta marri...

Xhevdet Haxhiu: E kam shumë shkurt, aty ku e ka Luli për materialet që vijnë nga gjykatat. Në programin e sistemit gjyqësor janë dy programe buxhetore: është programi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku të gjitha kërkesat dalin nga strukturat këtu brenda dhe përpunohen nga një ekip që është ekipi i programit buxhetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ekipi tjetër i programit të gjykatave ka një punë shumë më voluminoze dhe ne disponojmë materialet e ardhura nga 38 gjykatat për shpenzime personeli, materialet e ardhura nga gjykatat për shpenzime operative, materialet e ardhura nga gjykatat për të 38 gjykatat, në mënyrë të saktë dhe koncize, të administruara nga investimet, për shpenzime kapitale për investimet. Janë pasqyra pa fund në A3 dhe në A4, të cilat janë të ndara sipas ekipeve të programeve dhe i kanë administruar këto të dhëna, i kanë përpunuar, i kemi konsultuar bashkërisht me të dy ekipet, unë në cilësinë e nëpunësit zbatues, zonja Laze në cilësinë e drejtuese së departamentit, zoti Rudin Baqli në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm dhe në cilësinë e nëpunësit të autorizues të institucionit qendror, siç është KLGJ. Kemi një kuti të madhe, e kam këtu përpara, jeshile, që është me të gjithë këto dokumenta, që në çdo moment ne mund t'i vëmë në dispozicion. I kemi marrë edhe në "hard copy", i kemi marrë edhe me e-mail, që në muajin mars.

Dua të shtoj pak në lidhje me atë çfarë tha zonja Laze, që në mars ka dalë një akt normativ nga Këshilli i Ministrave, i cili hoqi, përjashtimisht për vitin 2020, të gjitha fazat dhe procedurat për kërkesat buxhetore "mos të ndiqet asnjë fazë" dhe i lanë në rënie të lirë. Por struktura jonë përgjegjëse, ka vazhduar punën në mars, prill, maj, qershor, deri kur erdhën kërkesat buxhetore, tavanet përfundimtare buxhetore nga Ministria e Financës, më 28 korrik, kemi vazhduar punën sikur nuk ekzistonte akti normativ, pra

kemi vazhduar punën duke marrë parasysh volumin e madh të punës që ka ky proces. Është një proces shumë-shumë voluminoz. Ndoshta nuk kuptohet puna, por ai material që është përgatitur, ka dashur shumë-shumë kohë. E gjithë struktura, me në krye Laze, kemi punuar, kur erdhën këto tavanet javën e fundit, me 28, deri ditën e martë në darkë, kur e kemi dërguar të gjithë anëtarëve.. është mbyllur me sukses i gjithë ky proces. Megjithatë, ky është në gjykimin tuaj. Kaq kisha.

Naureda Llagami: Faleminderit për sqarimin.

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, unë propozoj që ta hedhim në votim, a jemi dakord ta shtyjme.

Brikena Ukperaj: A mund të flas?

Naureda Llagami: Po!

Brikena Ukperaj: Në fakt, në vlerësimin tim, nëse një anëtar i Këshillit nuk është i përgatitur për të votuar për një çështje të rendit të ditës, nuk ka çfarë të hedhim në votim sepse proceduralisht ai nuk voton dot. Por ajo që është e rëndësishme është që këtë duhet ta vendosim standard për të ardhmen sepse në të shkuarën kemi mbajtur dy standarde të ndryshme. Ka qenë një rast për shembull, rasti i Dvoranit, ku unë nuk votoja dot dhe përsëri, me shumicë votash, vendosët që çështja të futej në rend dite. Që mos të kemi më qëndrime që bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, proceduralisht vlerësoj që nëse një anëtar nuk është në gjendje që të votojë për një çështje të rendit të ditës, nuk ka se çfarë të votohet, sepse nuk mund të imponohet vullneti i shumicës, anëtarit, qoftë edhe për të pasur një votim kundër. Prandaj në vlerësimin tim, proceduralisht, meqenëse ka dy anëtarë të Këshillit që kërkojnë që mbledhja të shtyhet për një datë tjetër dhe kjo çështje t'i kalojë rendit të ditës të mbledhjes tjetër, vlerësoj që duhet të shtyhet dhe nuk ka se çfarë të votojmë. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Mundem, Kryetare?

Naureda Llagami: Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Atëherë, thjesht për sqarim. Ndoshta kështu e vlerëson Brikena, por unë nuk mendoj se janë rastet e ngjashme. Diskutimi i rastit që përmendi, ishte të

futej apo jo në rendin e ditës dhe ajo mbledhje është shtyrë pikërisht për këtë gjë, pastaj për t'u përgatitur dhe për t'u bërë relacioni. Diskutimi në fillim, që u hodh në votim, ishte të futeshe apo jo në rendin e ditës, kurse tani po diskutohet të shtyhet apo jo shqyrtimi; dhe të gjithë biem dakord që (mos ta përsëris të njëjtën pikë), në këtë moment, mendoj që nga ana procedurale nuk mund të hidhet në votim kjo pjesë sepse të gjithë e dimë, materialet kanë ardhur dje. Unë dua shumë ta falënderoj të gjithë ekipin që ka punuar. Vetëm diçka dua të theksoj Xhoda, në fund vendos Këshilli dhe përgjegjësinë për atë që do votohet e kemi ne dhe unë nuk mund të votoj pa e ditur se çfarë po votoj, pavarësisht punës së shkëlqyer dhe të palodhur që keni bërë juve, përsëri e theksoj, ju falënderoj, puna është që unë duhet ta kuptoj se çfarë po votoj sepse edhe formalisht, kush e dëgjon këtë gjë thotë -“më fal, po çfarë votove, kur nuk e kishe lexuar dhe kur nuk e ke kuptuar se çfarë po voton”? Se tani, bëhet fjalë për një buxhet afatmesëm deri në 2023-shin. Ju thoni që i keni kutitë aty, që i keni lexuar, i keni shfletuar, i keni studiuar, por unë nuk mund ta studioj pasi të votoj. Ju thatë që mund t'i vini në dispozicion, por çfarë kuptimi kanë ta kemi në dispozicion pasi votohet?!

Nëse kjo vendimmarrje ka një natyrë të veçantë, që ne edhe mund ta ndryshojmë më vonë për “x” apo “y” arsye, okej, mbase kjo do të kishte vlerë të diskutoheshe nga pikëpamja, ndoshta edhe procedurale. Por nëse unë marr një vendim që sjellë nesër pasoja juridike, unë s'mund ta bëjë këtë gjë pa e kuptuar se çfarë po bëj. Faleminderit!

Luljeta Laze: Ka mundësi?

Lidhur me sa shpjegon zonja Kadi.

Bruna, çështja është që neve këtu kemi bërë programim të buxhetit, të nevojave tona dhe bazuar tek këto parashikime, por dhe jo vetëm, edhe tek ato se çfarë ka niveli makroekonomik dhe çështje të tjera që ka buxheti i shtetit, do kemi miratimin e buxhetit. Në përgjithësi, ajo që ndodh me buxhetin dhe me miratimin e tij, pavarësisht argumentave dhe specifikisht për këtë vit të vështirë (2021-shin e kam fjalën), besoj që nuk do ketë edhe vend shumë për diskutim, pavarësisht që ne i kemi vendosur argumentat tona se çfarë kërkojnë, pse i kërkojnë, të sqaruara deri në detaje çdo gjë.

Për të shpjeguar atë momentin e dyshimit që the që “se do sjellë pasoja”. Është e vërtetë që sjellë pasoja, por ne nuk është se nuk i kemi konsideruar kërkesat buxhetore,

dhe ne keni vendosur si kërkesa çdo gjë që gjykatat kanë sjellë, por kjo e filtruar edhe nga specialistët përkatës dhe në disa raste kur - se specialistët për atë punë janë – kur ato e gjejnë të arsyeshme, dhe ne pastaj si ekip, që shiko se kjo kërkesë nuk qëndron apo shiko se referuar faktit tjetër që për sa i përket pajisjeve elektronike për shembull, skanerëve dhe të tjerë, mbahet një data-bazë e plotë e të gjithë pajisjeve dhe edhe kur është e papërgjegjshme gjykata në programimet përkatëse, është specialisti këtu që thotë “ka 10 vjet me këto kompjuter”, apo një pajisje e caktuar elektronike ka përfunduar afatet e saj dhe mund të jetë në risk për të prishur të gjithë çështjet e tjera...

Brunilda Kadi: Luli, më fal që të ndërpresë.

E kuptoj shumë mirë. E kuptoj shumë mirë.

Thjesht, unë duhet të kem mundësi që ta përpunoj materialin. Më kupton?

Se s'mund të votoj pa e kuptuar.

Luljeta Laze: Absolutisht!

Më bëni pyetje që të më kuptoni.

Ne jemi të gatshëm që të përgjigjemi për çdo gjë që juve doni. Megjithatë, kjo është vendimmarrja juaj. Vetëm do t'ju lutesha që të mbani parasysh këtë që mbledhja duhet bërë të paktën deri më datë 20, që ne të kemi kohë që të punojmë.

Naureda Llagami: Atëherë, a gjejmë një ujdi të gjithë bashkë, edhe Bruna edhe Marçela kanë një farë të drejte tek mënyra që duan patjetër të konsultohen me aktet, por nga ana tjetër, unë do i ftoja edhe anëtarët të kenë një lloj fleksibiliteti për t'i lënë mundësi edhe stafit që të paktën të përpunojnë aktet pa prishur pushimet që ata kanë programuar. Pra të jemi pak fleksibël tek kjo pjesa.

Brunilda Kadi: Shumë dakord. Shumë dakord jemi. Patjetër!

Naureda Llagami: Të kemi ujdi nga të dy palët, pra edhe ju të jeni fleksibël në momentin që stafi do jetë gati, pra mos të lëmë shumë procedura dhe shumë formalizma, në momentin që stafi do i ketë gati për t'i bërë këto. Si mendoni?

Alban Toro: Luli, impakti që do sjellë harta e re gjyqësore, a duhet të ketë një farë parashikimi tek ky projektbuxhet deri në vitin 2023 a impakton kjo nëse ne nuk e bëjmë tani më pas?

Luljeta Laze: Atëherë, ne hartën e re gjyqësore nuk e kemi të miratuar, kështu që për 2021-shin nuk kemi parashikuar asnjë gjë lidhur me hartën e re gjyqësore. Në këtë situatë ishim për çështjen e projektit të Durrësit dhe në këtë rast nuk mund të marrim vendime. Tani, ne i kemi në vëmendje çfarë ju thoni. Nuk mund të marrim vendime pa u miratuar harta e re gjyqësore. Kjo gjë u la. Atëherë, neve presim, me miratimin e hartës së re gjyqësore, dhe në fakt, nuk është se impakton për 2021-shin sepse për 2022-shin dhe për 2023-shin, për secilin nga vitet, ndërtohet nga e para buxheti, pavarësisht që këtu thuhet diçka.

Naureda Llagami: Alban, të lutem, se jemi në procedurë. Për ta evituar diskutimin, shkojmë tek pjesa tjetër kur të jemi në themel. Tani jemi në procedurë. Mundet që t'i biem shkurt dhe të dakordësohemi dhe ta shtyjme çështjen?

Alban Toro: Më shkurt se kaq, unë nuk e kuptoj.

Se në qoftë se ne nuk kemi parashikuar diçka për hartën e re gjyqësore, nesër-pasnesër do na duhet që t'i kthehemi prapë. Dhe këtë pyeta unë, -a afekton ky mosparashikim në këtë projektbuxhet që ne po paraqesim apo jo? Ka më shkurt?

Xhevdet Haxhiu: A mund të shtoj diçka për Albanin të lutem?

Marçela Shehu: Jo! Kam frikë se po i hyjmë themelit tani

Naureda Llagami: Unë do doja që këto çështje t'i dëgjonim kur ne të pranojmë për shqyrtim aktin. Tani jemi tek procedura, e tha edhe Brikena, e tha edhe Marçela, e tha edhe Bruna. Nuk po e hedhim në votim për procedurë, po pranojmë që ta shtyjme projekt-aktin, kuptohet, me fleksibilitetin që kur të ketë mundësi stafi, ku përfshihet Luli edhe Xhoda dhe drejtorja përkatëse që ta përfshijmë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe ato mos të prishin planet e tyre të programuara. Dakord?

Jemi dakord që ta shtyjme, që ta tërheqim?

Marçela Shehu: Po, dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord dhe pastaj të na sugjerojë Luli me Xhodën ato datat që mendojnë që është më e përshtatshme.

Naureda Llagami: Ndërkohë, nëse keni diskutime dhe keni gjëra, kuptohet Lulin me Xhodën i keni fleksibël gjatë kësaj periudhe, që t'ju përgjigjen çështjeve që i keni me merak ndërkohë.

Xhevdet Haxhiu: Më falni, një fjalë shkurt?

Naureda Llagami: Xhoda tani të lutem, ta mbyllim këtë çështje?

Juve do na thoni datat tuaja të mundshme, ashtu siç u dakordësuam. Dakord?

Xhevdet Haxhiu: Ne jemi gati kur të na thonë, për çfarë kërkojnë anëtarët, ne jemi gati t'ua vëmë në dispozicion, duke filluar nga sot.

Naureda Llagami: Dakord. Faleminderit!

Atëherë, çështja shtyhet për një datë tjetër, për t'i lënë kohë të gjithë anëtarëve që të njihen me dokumentacionin dhe me projekt-aktin, por kuptohet, brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të procedurave që kërkon shqyrtimi i kësaj çështjeje.

Atëherë, kalojmë tek çështja e parë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 18 dhe 23 qershor, 2 korrik, 7 korrik, 9 korrik dhe 16 korrik.

Procesverbalet, siç jeni në dijeni ju janë përcjellë nga stafi. Nëse keni pasur komente, paqartësi. Po ashtu, unë do t'ju ftoja për votimin e këtyre procesverbaleve. Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 18.06.2020, 23.06.2020, 02.07.2020, 07.07.2020,

09.07.2020 dhe 16.07.2020. 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 dhe 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.08.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, si dhe vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 16:00 dhe mbaroi në orën 17:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
3. **Medi Bici** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Brunilda Kadi** (anëtare)
6. **Ilir Toska** (anëtar)
7. **Brikena Ukperaj** (anëtar)
8. **Erjon Muharremaj** (anëtar)
9. **Marçela Shehu** (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Shënim 2: Largohet në fillimin e shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës dhe nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Alban Toro** (shih fillimin e procesverbalit).

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, si dhe vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në shqyrtimin e projekt-aktit tjetër, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, si dhe vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Paraprakisht, dëshiroj t’ju informoj, Këshillin, se zoti Toro ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.84 dhe nr.87 si dhe vendimit nr.245, datë 09.07.2020, për shkak se në këto procedura ka konkurruar bashkëshortja e tij, gjyqtarja {...}. Kërkesa

është pranuar nga ana ime me vendim nr. 3, datë 06.08.2020. Për këtë arsye, zoti Toro nuk mund të jetë i pranishëm në shqyrtimin e këtij projekt-akti. Kështu që ai mund të largohet nga mbledhja.

Alban Toro: Sapo doja ta thoja.

Ju uroj punë të mbarë. Mirupafshim!

Naureda Llagami: Për më shumë detaje, fjalën po ia jap relatorit të projekt-aktit, zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, si dhe vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Arsyeja e përgatitjes së këtij projektvendimi është se për të gjitha pozicionet e përmendura më lart, afati i kandidimit ka mbaruar më datë 30 korrik 2020.

Për këtë projektvendim është përgatitur edhe një relacion shpjegues i cili është shpërndarë paraprakisht dhe më lejoni të lexoj atë.

“Në nenin 136, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: “Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi”, ndërsa në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. ...”.

Ndërkohë, sipas nenit 147/a, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ushtron edhe funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit, kurse sipas shkronjës “ë” të këtij neni, Këshilli ushtron edhe çdo funksion tjetër të caktuar me ligj.

Pikërisht, përgjegjësia si më lart e Këshillit të Lartë Gjyqësor në kuadër të emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, si pjesë e përgjegjësisë për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore, gjen rregullim dhe në Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar, pikërisht në nenin 85, pika 2 dhe 3, si dhe në nenin 86, shkronja “ç”, ndërkohë që në shkronjën “ë” të kësaj dispozite, parashikohet përgjegjësia e Këshillit në lidhje me çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore.

Më tej, përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore, përfshirë edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, duke ushtruar funksionin e propozimit të kandidatëve Presidentit të Republikës, gjen rregullim dhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikërisht në nenin 48, pika 11, ndërkohë që në pikën 7 të kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i Këshilli për verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Ndërkohë, në lidhje me verifikimin e kandidatëve, përfshirë edhe për ata për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. Sipas këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c”, procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit, ndër të tjera, “jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë”.

Pikërisht, në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.84, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me Vendimin nr.87, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), procedura për të cilat ka përfunduar afati i kandidimit më datë 30.07.2020, si dhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale) dhe me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës

administrative), procedura për të cilat ka përfunduar afati i kandidimit po më datë 30.07.2020.

Në vijim, sipas Kreut V, Seksioni A, pika 2, të aktit nënligjor si më lart, “Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit për secilin kandidat”. Në zbatim të këtij rregulli, Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, do të duhet të caktojë dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ndërkohë, në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, përcaktohet se: “Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”.

Nisur nga ky rregullim, Këshilli duhet të mbajë në konsideratë faktin se, referuar kandidatëve për secilin pozicion të lirë të shpallur me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 si dhe me Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, në total nga 19 kandidatë që kanë aplikuar fillimisht, 2 prej prej tyre më pas kanë hequr dorë nga kandidimet për këto pozicione, sikurse do parashtrohet në vijim, duke qenë aktualisht 17 kandidatë, ndërkohë, nga këta rezulton se 10 nga ata janë në proces e sipër të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit:

- për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë sipas Vendimit nr. 151, datë 06.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.82 dhe nr.85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe Vendimit nr. 201, datë 11.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

Po kështu janë në procedurë e sipër edhe për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas Vendimeve nr. 152, datë 06.05.2020, nr. 190 dhe nr. 191, datë 04.06.2020;

Po ashtu janë në proces e sipër verifikimi edhe për procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe/ose Gjykatën Administrative të Apelit sipas Vendimit nr. 238, datë 07.07.2020.

Për një situatë të tillë, në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të aktit nënligjor si më lart, është parashikuar se: “Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”. Në kuptim dhe zbatim të këtij rregulli, për kandidatët që kanë kandiduar për disa pozicione të lira në proces shqyrtimi, sa i përket kriterëve të pasurisë dhe figurës, që janë të njëjtë për çdo lloj kandidimi, procedura e verifikimit që është në proces e sipër në lidhje me to, do të duhet të konsiderohet e vlefshme edhe për kandidimin e këtyre kandidatëve për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.

Sa i përket kandidatëve që kanë kandiduar edhe në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e shpallura më datë 26.02.2020 dhe 28.05.2020, të dhënat për kandidimet e tyre janë si vijon:

1) Kandidatja znj. {...} - ka kandiduar në total për 5 pozicione të lira që janë në proces - për 2 pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, si dhe për 3 pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura respektivisht me Vendimet nr. 180, nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020;

2) Kandidatja znj. {...} - ka kandiduar në total për 7 pozicione të lira që janë në proces - për 3 pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe për 4 pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, po në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020;

3) Kandidati z. {...} - ka kandiduar në total për 10 pozicione të lira që janë në proces - për 4 pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë

09.07.2020, për 3 pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, po në këtë gjykatë, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe për 4 pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, po pranë Gjykatës së Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020. Zoti Lara fillimisht ka kandiduar për 6 pozicione të lira, të shpallura fillimisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 26.02.2020, ndërkohë që Këshilli, pas njoftimeve respektive për përzgjedhjen nga ana e tij për vetëm këto 3 pozicione, mbasi mori mendimin e tij, me vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, vendosi mospërfshirjen e aplikuesit z. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.

4) Kandidatja znj. {...} - ka kandiduar në total për 7 pozicione të lira që janë në proces - për 3 pozicione të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallura me Vendimet nr.88, nr.90 dhe nr.91, datë 26.02.2020, si dhe për 3 pozicione të lira në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr. 242, nr. 243, datë 09.07.2020;

5) Kandidati z. {...} - ka kandiduar në total për 7 pozicione të lira që janë në proces - për 3 pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe për katër pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, po në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020;

6) Kandidatja znj. {...} - ka kandiduar në total për 5 pozicione të lira që janë në proces - për 4 pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, si edhe për 1 pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020. Vlen të përmendet se kandidatja zonja {...} fillimisht kandidoi për 3 pozicione të lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me vendimet nr. 82, 83 dhe 86, datë 26.02.2020, mirëpo në rastin e hapjes së procedurës për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, kjo gjyqtare kandidoi për 2 pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me vendimet 179 dhe

180, datë 28.05.2020. Në rastin e fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve për pozicionet e lira respektive në gjykatën e apelit, në atë moment kandidatja kishte kandiduar për ngritjen në detyrë për 5 pozicione të lira, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me njoftimin e datës 2 korrik 2020 e ftoi të përcaktonte tre pozicione të lira për të cilat do të vijonte kandidimin. Në përgjigje të kësaj ftese, në njoftimin e datës 03.07.2020 kandidatja shpreh se për zgjedh të vijojë konkurrimin për vakancat në Gjykatën e Lartë, në fushën e së drejtës administrative, të shpallura me vendimet 82, 83 datë 26.02.2020 dhe vakancën në Gjykatën e Apelit Tiranë, në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020. Mbi këtë bazë, me vendimin nr. 238, 07.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera ka vendosur mosfillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020. Po ashtu, në vendimin nr. 261, datë 23.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

7) Kandidatja znj. {...} - ka kandiduar në total për 7 pozicione të lira që janë në proces - për 3 pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe për 4 pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, po në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020. Në lidhje me kandidaten znj. {...} vlen të përmendet se referuar datës së paraqitjes së kërkesave pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton të ketë kandiduar për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë me vendimet nr. 85, 84, 83, 86, 87 datë 26.02.2020. Në rastin e fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve për pozicionet e lira respektive, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, ndër të tjera ka vendosur 5. Mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në

detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë. Ndaj këtij vendimi të Këshillit, kandidatja ka paraqitur ankim përpara Gjykatës Administrative të Apelit, ku çështja vijon të jetë ende në gjykim.

Përveç sa sipër, rezultoi që edhe dy nga kandidatët që kanë aplikuar rishtazi, znj. {...} si dhe z. {...}, të kenë aplikuar për 4 pozicione të lira në Gjykatën e Lartë. Konkretisht:

8) Kandidatja znj. {...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces - për 4 pozicione të lira në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020;

9) Kandidati z. {...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces - për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Lartë, të shpallura në datë 09.07.2020;

Në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës”.

Në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite ligjore, sikurse është bërë me dije në rastet e njoftimeve të shpalljes së procedurave të ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë ose të specializuar, por edhe të praktikës së deritanishme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konsideruar se:

- Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë ose të specializuar mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme ngritjeje në detyrë.

- Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës.

- Në rast të kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira në proces, kandidati duhet të rikonsiderojë kandidimet e tij, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat vijon kandidimin. Mospërcaktimi i tyre nga vetë kandidati, passjell identifikimin e vullnetit të tij në bazë të kohës së kandidimeve, duke filluar nga ai i bërë më parë ose në rastin e

shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, në bazë të radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë.

- Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar/përmbyllur dhe kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të të drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira.

Në kushtet kur kandidatët e sipërcituar kishin kandiduar për më shumë se tre pozicione të lira në proces, ndërsa ligji kufizon të drejtën e kandidimit deri në tre të tillë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, më datë 04.08.2020, i njoftoi elektronikisht duke i ftuar kandidatët të rikonsideronin kandidimet e tyre, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat do të vijonin kandidimin.

Shtatë nga kandidatët, më datë 04.08.2020 dhe 05.08.2020, në rrugë elektronike, rikonsideruan tre pozicione të lira për të cilat do të vijonin të kandidonin, duke përcaktuar jo më shumë se tre pozicione që kanë kandiduar dhe që janë në proces, konkretisht:

1) Kandidatja znj. {...} është shprehur se: "... referuar dhe nenit 48 të ligjit me Nr.96/2016, përzgjedh 3 pozicione ku kandidoj, si vijon: Dy pozicionet e shpallura të lira në GJL, fusha e së drejtës administrative, për të cilët kam paraqit dhe kërkesat përkatëse. Pozicionin e shpallur të lirë në GJAA, që do mbetet për vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë, pasi kam ardhur në dijeni se, në një nga pozicionet është caktuar z. {...}. Heq dorë nga kërkesa për kandidim në pozicionin e shpallur në Gj.A.Tiranë, fusha penale dhe nga kërkesa për kandidim në pozicionin e shpallur në GJAA, por që është caktuar më pas, z. {...}. Ju kërkoj ndjesë, që nuk kam përcaktuar këtë të fundit me nr. vendimi të KLGJ-së për shpallje pozicioni, pasi jam në pamundësi objektive ta përcaktoj. Megjithatë, mendoj se vullneti im për vazhdimin e konkurrimit dhe përzgjedhjen e 3 pozicioneve shprehet qartë dhe në këtë formë...";

2) Kandidatja znj. {...} është shprehur se: "... Së pari, unë kam kandiduar në dy pozicione të lira, për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë: një pozicion i lirë në fushën e të drejtës civile dhe një pozicion i lirë në fushën e të drejtës penale. Në këto rrethana kam aplikuar për vendet vakante që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shpallur për secilin nga këto pozicione të lira. Në vlerësimin tim, unë kam respektuar pikën 6 të nenit 48 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve". Së dyti, në lidhje me sa keni parashtruar në njoftimin tuaj, shpreh preferencën time për të kandiduar në pozicionin e

lirë në fushën e të drejtës civile, vendi vakant i shpallur me vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, si dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, vendi vakant i shpallur me vendimin nr. 242, datë 09.07.2020 dhe vendi vakant i shpallur me vendimin nr. 244, datë 09.07.2020”;

3) Kandidatja znj. {...} është shprehur se: “... Zgjedh të listoj preferencat e mia si më poshtë: 1-Për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 2-Për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 3-Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë”;

4) Kandidati z. {...} është shprehur se: “... Rikonsideroj kërkesat për kandidim për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë në 3 (tre) pozicione të lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet: - nr. 241, datë 09.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor; -nr. 242, datë 09.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor; - nr. 244, datë 09.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për të gjitha kërkesat e tjera për kandidim, për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, të paraqitura prej meje, unë heq dorë përfundimisht”;

5) Kandidatja znj. {...} është shprehur se: “... Si në procedurën e ngritjes në detyrë të shpallur në datën 28.02.2020, ashtu dhe në procedurën e ngritjes në detyrë të shpallur në datën 28.05.2020, ashtu dhe procedurën e ngritjes në detyrë të shpallur në datën 09.07.2020 unë kam respektuar numrin e kandidimeve, jo më shumë se 3. Nga ana tjetër procedura e ngritjes në detyrë e shpallur në datë 28.02.2020 me vendimin nr.82, datë 26.02.2020, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.96/2016, përfshirë dhe periudhën e pezullimit, më rezulton të ketë përfunduar në datë 28.07.2020, duke u përmbushur afati 3-mujor brenda të cilit duhet të ishte bërë përzgjedhja. Gjithsesi në përgjigje të sa ju kërkoni përzgjedh vakancat në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr.82 dhe nr.83, datë 26.02.2020 dhe vakancën në Gjykatën e Apelit Tiranë, juridiksioni i përgjithshëm në fushën e të drejtës civile shpallur me vendimin nr.179, datë 28.05.2020”;

6) Kandidatja znj. {...} është shprehur se: "... Në kushtet kur kam kandiduar për katër pozicione të lira, ndërsa ligji kufizon të drejtën e kandidimit deri në tre të tillë, përcaktoj tre pozicionet e lira për të cilat kandidoj, për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

7) Kandidati z. {...} është shprehur se: "... Në përgjigje të këtij njoftimi dhe kërkesave të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, deklaroj se do të vijoj kandidimin për pozicionet vakante si më poshtë: -Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 242, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;- Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;- Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Heq dorë nga kandidimi për:- Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ndërkohë, në përgjigje të ftesës së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, më datë 04.08.2020, në rrugë elektronike, kandidati z. {...}, është shprehur se: "... Duke sqaruar edhe një herë se në të gjitha Vendimet tuaja nr.82, 83, 84, 85, 86, 87, 121, 122, 123, 124 dhe 125, Ju keni shpallur VEND vakant për pozicionin e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, rikonfirmoj se kandidoj në secilin Vend prej tyre për pozicionin e ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë!...”.

Kandidatja znj. {...} nuk i është përgjigjur ftesës së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës të dërguar në adresën e saj zyrtare elektronike. Vlen të përmendet se për ftesën e dërguar në adresën e saj zyrtare elektronike, kandidatja është njoftuar, më datë 4 dhe 5 gusht 2020, nëpërmjet mesazheve telefonike (sms), përveç së është tentuar pa sukses komunikimi telefonik me të në datën 6 gusht 2020.

Bazuar në vullnetin e kandidatëve sipas qëndrimit të shprehur nga ata, përmes kërkesave me shkrim të datës 04.08.2020 dhe 05.08.2020, të dërguara në rrugë elektronike, rezulton që tashmë ata kanë përcaktuar tre pozicionet e lira në proces për të cilat do të vijojnë kandidimin dhe më konkretisht:

1) Kandidatja znj. {...} ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin e saj për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me Vendimet nr. 84, datë 26.02.2020

dhe nr. 245, datë 09.07.2020, si dhe për një nga pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit Administrativ, të shpallura me Vendimet nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020.

2) Kandidatja znj. {...} ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin e saj për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me Vendimet nr. 85, datë 26.02.2020; nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, duke hequr dorë nga kandidimet e tjera;

3) Kandidati z. {...}, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si më parë dhe duke mos rikonsideruar asnjë nga pozicionet për të cilat ai ka kandiduar, ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin për pozicionet për të cilat ai ka kandiduar, ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin për pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e Lartë me Vendimet nr.82, nr. 83, nr.84, nr. 85 dhe nr.87, datë 26.02.2020, si dhe me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020;

4) Kandidatja znj. {...} ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin e saj për pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit të Posaçëm për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallura me Vendimet nr. 88 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, si dhe për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë, të shpallur me Vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, duke hequr dorë nga kandidimet e tjera;

5) Kandidati z. {...} ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin e tij për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me Vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, duke hequr dorë nga kandidimet e tjera;

6) Kandidatja znj. {...} ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimet e saj për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, si dhe për pozicionin e lirë në Gjykatën e Apelit Tiranë të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, duke hequr dorë nga kandidimet e tjera;

7) Kandidatja znj. {...} ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin e saj për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me Vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, duke hequr dorë nga kandidimi tjetër;

8) Kandidati z. {...} ka shprehur vullnetin për të vijuar kandidimin e tij për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me Vendimet nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, duke hequr dorë nga kandidimi tjetër.

Ndërkohë, sikurse më sipër u përmend, kandidatja znj.{...}, brenda afatit të përcaktuar datë 05.08.2020 nuk ktheu përgjigje për sa iu kërkua nga ana e Komisionit. Në

njoftimin e dërguar në adresën elektronike, sikurse edhe në rastin e kandidatëve të tjerë, kësaj kandidate iu bë me dije se në rast të mospërcaktimit të tre pozicioneve për të cilat do të vijonte kandidimin, kjo do të sillte si pasojë identifikimin e vullnetit të saj në bazë të kohës së kandidimeve, duke filluar nga ai i bërë më parë ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, në bazë të radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Përveç kësaj, duke qenë se në rastin e fillimit të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, Këshilli pasi konsideroi dhe qëndrimin e shprehur të kësaj kandidate për të përcaktuar tre pozicionet e lira në proces për të cilat do të vijonte kandidimin, me Vendimin nr. 201/5, datë 11.06.2020, vendosi të mos e përfshinte kandidaten në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020, të Këshillit, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë. Në këto rrethana, kjo kandidate vijon kandidimin për dy pozicioneve të lira të shpallura me Vendimet nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, që janë tashmë në proces verifikimi, përveç se, sipas vendimit të tij të sipërcituar, Këshilli e ka konsideruar paraprakisht atë si kandidate edhe për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020. Për rrjedhojë, kjo kandidate, në mënyrë të heshtur, ka pranuar të vijojë kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86, nr. 87, datë 26.02.2020.

Në vijim, në rastin e kandidatit z. {...}, rezulton që ky kandidat është tashmë në tre procedura ngritjeje në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020. Në përgjigjen e dërguar, pas kërkesës për të rikonsideruar tre pozicionet e lira për të cilat vijonte kandidimin, ky kandidat u shpreh se kandidonte për të gjitha pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, qëndrim që e ka mbajtur edhe më parë, por që është gjetur jo i bazuar nga Këshilli, sikurse edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, mbi ankimin e kandidatit, ka vendosur rrëzimin e padisë. Në këto kushte, ky kandidat, vijon kandidimin për tre pozicionet e lira në proces, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, sipas vendimmarrjes së

mëparshme të Këshillit, duke qenë kështu në kushtet e ndalimit nga ligji për kandidimet për ngritjen në detyrë për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe me Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020.

Gjithashtu, në rastin e kandidatit z. {...}, i cili ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me Vendimin nr.84, datë 26.02.2020, duke qenë se ky kandidat kishte aplikuar edhe për pozicionet e lira pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe Gjykatës Administrative të Apelit (të hapura më vonë në kohë me vendimet e datës 28.05.2020), ndërkohë që ishte në proces për dy pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, pas kërkesës së Këshillit për të rikonsideruar pozicionet e lira për të cilat kërkonte të vijonte kandidimin në rastin e fillimit të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, në datën 03.07.2020 në rrugë elektronike, kandidati z.{...} është shprehur se: “... saktësoj se vendet vakante në të cilat kërkohet të kandidoj janë: Për pozicionin e lirë si gjyqtar në Gjykatën e Lartë në kolegjin administrativ të shpallur me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 të KLGJ, për pozicionin e lirë si gjyqtar në Gjykatën e Lartë në kolegjin administrativ të shpallur me vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 të KLGJ dhe për pozicionin e lirë si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të KLGJ-së”. Në këtë mënyrë, ky kandidat ka hequr dorë nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me Vendimin nr. 84, datë 26.02.2020.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga 15 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale), si dhe me Vendimin nr.245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës administrative), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për secilin nga 11 kandidatët që kanë kandiduar rishtazi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, pikërisht për pozicionet e lira për të cilat fillon procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit sipas pikës 1 të projektvendimit.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet afati i dorëzimit nga kandidatët të deklaratës së pasurisë që propozohet të jetë deri më datë 11.09.2020, marrë parasysh këtu që në muajin gusht nga ana e institucioneve, qoftë private apo shtetërore, ku do të kërkohen dokumente nga kandidatët në funksion të plotësimit të deklaratës së pasurisë, përgjithësisht merren pushimet vjetore dhe nuk ofrojnë ose ofrojnë shërbim të reduktuar.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se për kandidatët znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ose në gjykatat e apelit të juridiksionit të posaçëm, procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për një ose disa nga pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet mospërfshirja e aplikuesit z. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për katër pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 dhe me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira në proces.

Në pikën 6 të projektvendimit përcaktohet mospërfshirja e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira në proces.

Pika 7 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e

lirë në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura respektivisht me Vendimin nr.87, datë 26.02.2020 dhe Vendimet nr.241, dhe nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj.{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione më datë 05.08.2020.

Pika 8 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.242, dhe nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj.{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione më datë 04.08.2020.

Pika 9 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimin nr.84, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj.{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione më datë 05.08.2020.

Pika 10 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr.87, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z.{...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione më datë 05.08.2020.

Pika 11 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj.{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion më datë 05.08.2020.

Pika 12 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr.84, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z.{...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020.

Pika 13 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr.241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z.{...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion më datë 05.08.2020.

Më tej, në pikën 14 të projektvendimit përcaktohet se disponimi sipas pikave 5 dhe 6, të këtij vendimi, u njoftohen aplikuesve {...} dhe {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ndërkohë që në pikën 15 të projektvendimit përcaktohet se aplikuesit {...} dhe {...} kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit respektivisht të pikave 5 dhe 6, të këtij vendimi.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lidhur me caktimin e relatorit për secilin nga shtatë kandidatët që kanë kandiduar rishtazi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, pikërisht për tre nga pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe asaj civile, për të cilat fillon procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit sipas projektvendimit të propozuar, pra për kandidatët {...}, duhet të mbahet në konsideratë edhe dorëheqja e zotit Alban Toro anëtari i përhershëm i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, shkak për të cilin do duhet që në procedurat e shortit të përfshihen vetëm dy prej anëtarëve të përhershëm të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Ilir Toska dhe znj. Marçela Shehu.

Ndërsa caktimin e relatorit për secilin nga katër kandidatët që kanë kandiduar rishtazi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet në fushën e të drejtës penale, në kushtet kur kandidimi i bashkëshortes së z.Toro nuk interferon me këto katër procedura ngritjeje në detyrë, ky i fundit nuk ka pengesë për t’u përfshirë në short krahas dy nga anëtarëve të tjerë të përhershëm të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Sa i përket ndarjes së procedurave të verifikimit, Komisioni propozon që për 7 kandidatë që janë në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe të të drejtës civile, të shpërndahen në këtë mënyrë: unë të marrë 3 nga kandidatët, ndërsa zonja Shehu të marrë 4 nga kandidatët për verifikim. Ndërkohë që për 4 kandidatët që konkurrojnë për procedurat e ngritjes në detyrë në

fushën e së drejtës penale, ata të ndahen në këtë mënyrë: unë të marr 1 nga kandidatët, zonja Shehu të marrë 1 nga kandidatët dhe zoti Toro të marrë 2 kandidatët. Në këtë mënyrë do të bëjmë një shpërndarje më efektive për të pasur më efektivitet ndaj përfundimit sa më parë të këtyre procedurave. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Jemi dakord me propozimin e bërë nga zoti Toska mbi mënyrën e shpërndarjes së kandidatëve ndërmjet relatorëve?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, të hidhet procedura e shortit.

Shorti i parë: Futen fillimisht në enën e qelqit emrat e dy relatorëve: z. Ilir Toska dhe znj. Marçela Shehu. Më pas futen në enën tjetër të qelqit emrat e 7 kandidatëve: znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Tërhiqet emri i relatorit të parë, që rezulton zoti Ilir Toska.

3 kandidatët që bien në short janë: z. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Tërhiqet emri i relatorit të dytë, që rezulton zonja Marçela Shehu.

4 kandidatët që bien në short janë: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Mbyllet shorti për 7 kandidatët që konkurrojnë për procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative dhe të së drejtës civile.

Shorti i dytë: Futen fillimisht në enën e qelqit emrat e tre relatorëve: z. Ilir Toska, znj. Marçela Shehu dhe z. Alban Toro. Më pas futen në enën tjetër të qelqit emrat e 4 kandidatëve: znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Tërhiqet emri i relatorit të parë, që rezulton zonja Marçela Shehu.

Kandidatja që bie në short është: znj. {...}.

Tërhiqet emri i relatorit të dytë, që rezulton zoti Alban Toro.

2 kandidatët që bien në short janë: z. {...} dhe z. {...}.

Tërhiqet emri i relatorit të tretë, që mbetet të jetë zoti Ilir Toska.

Kandidatja që bie në short është: znj. {...}.

Mbyllet shorti për 4 kandidatët që konkurrojnë për procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin.

Përpara se të kalojmë në votim, dëshiroj që të përsëris edhe një herë caktimin e relatorit për secilin nga kandidatët, për ta kaluar në votim në tërësi projekt-aktin, sipas propozimit, së bashku me shortin. Kështu:

1. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
2. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
3. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska;
4. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
5. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
6. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska;
7. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
8. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
9. Për kandidaten znj. {...}, relatore znj. Marçela Shehu;
10. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
11. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro.

Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni, bashkë me caktimin e relatorëve.

Përpara se të hyjmë në votim, dëshiroj t'ju informoj se zoti Bici ka qenë prezent që në fillim të shqyrtimit të këtij projekt-akti në platformën “online”. Kështu që do marrë pjesë në votimin e këtij projekt-akti.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.08.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 16:00 dhe mbaroi në orën 17:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Edhe ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do të relatohet nga zoti Ilir Toska.

(Mbledhja rifillon pas hyrjes në platformë të zotit Toro.)

Ilir Toska: Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë

Gjyqësor”, në kushtet kur afati i kandidimit për këtë pozicion ka përfunduar dhe ka kandiduar një gjyqtar. Bashkëlidhur projektvendimit ju është shpërndarë edhe relacioni shpjegues në lidhje me projektvendimin, të cilin po e lexoj. Nuk po zgjatem në pjesën e parë në përgjegjësitë dhe funksionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sjell në vëmendje se pozicioni për të cilin ne do duhet të fillonim procedurën e verifikimit ka përfunduar afati i kandidimit (afati i kandidimit datë 27 korrik 2020) dhe në këtë procedurë ngritjeje në detyrë është paraqitur vetëm një kandidat, zoti {...}. Nisur nga kjo, në respektim të vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, konkretisht Kreut V, Seksioni A, shkronja “c”, Këshilli do duhet të fillojë procedurën e verifikimit jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit.

Pikërisht, në respektim të këtij vendimi, do duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për kandidatin që ka kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 223, datë 02.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim, të aktit të sipërpërmendur, sipas Kreut V, Seksioni A, pika 2 të tij, në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin e relatorit ndërmjet anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Në zbatim të këtij rregulli, Këshilli do duhet të bëjë brenda ditës së sotme edhe caktimin e relatorit, por referuar kandidaturës së paraqitur për këtë pozicion të lirë, rezulton që të ketë kandiduar edhe për ngritje në detyrë edhe për pozicione të lira në proces shqyrtimi për në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konkretisht në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, si dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Apelit Durrës, të shpallur me vendimin nr. 174, datë 28.05.2020, kandidim për këtë të fundit, në rastin e aplikimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kandidati ka hequr dorë, shkak për të cilin Këshilli do të duhet të vendosë përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të kandidatit për këtë pozicion të lirë.

Për situatën që paraqitet në rastin konkret, në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të aktit nënligjor si më lart, është parashikuar se: “Në rastin e kandidatit që ka kandiduar

njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”. Në kuptim dhe zbatim të këtij rregulli, në kushtet kur kandidati z.{...} ka kandiduar për disa pozicione të lira në proces shqyrtimi, sa i përket kritereve të pasurisë dhe figurës, që janë të njëjtë për çdo lloj kandidimi, procedura e verifikimit që është në proces e sipër në lidhje me to, do të duhet të konsiderohet e vlefshme edhe për kandidimin e këtij kandidati për pozicionin e lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nisur nga kjo, në rastin konkret nuk ka vend për caktimin e një relatori për kandidatin e vetëm z.{...}, ndërsa për këtë kandidat më herët jam caktuar pikërisht unë, sipas vendimit nr. 238, datë 07.07.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga dy pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërsa në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se për kandidatin e vetëm z. {...}, i cili ka kandiduar edhe për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, procedura e verifikimit të tij sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për pozicionin e lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me Vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toska për relatimin e projekt-aktit.

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim.
Ndryshe kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Këto ishin çështjet që kishim për diskutim në këtë mbledhje.

Mirë u takofshim në mbledhjen e radhës.

Mirupafshim!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor